



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Legjislatura e III-të

Nr. 02/09

Prishtinë, më 1.12.2009, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: **Haki Shatri, Safete Hadërgjonaj, Kosara Nikolić, Gani Koci, Arsim Rexhepi, Anita Morina, Sinavere Rysha dhe Enis Kervan, Riza Smaka.**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: **Vilson Ukaj,** dhe stafi i KIPRED në përkrahje të Komisionit (**Artan Venhari dhe Qemajl Marmullakaj**).

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: **Miranda Shala nga Ambasada Britanike, monitorues Zyra e Presidentit të Kosovës, OSCE dhe KDI.**

Kryesues: Haki Shatri, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara dt. 18.11.2009;**
- 3. Diskutim mbi Propozim Mandatin e Komisionit**
- 4. Të ndryshme**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime

Kryesuesi, prezantoi edhe anëtarët e Komisionit përfaqësueses së ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar e cila është menaxhere e projekteve të financuara nga ana e ambasadës përfshi këtu edhe projektin për asistencë Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara dt. 18.11.2009;

Procesverbali u miratua më vërejtjet dhe ndryshimet e kërkuara nga z. Enis Kervan.

z. Kervan kërkoi që procesverbalet në të ardhmen të përkthehen edhe në gjuhën turke pasi që janë dokumente që mbesin në arkivin e Komisionit dhe se komisionet e tjera gjithashtu i përkthejnë të gjitha dokumentet edhe në gjuhën turke. Kërkoi që në diskutimin e tij për pikën e tretë të rendit të ditës, të përmisohet fjala ku thuhet dy anëtar pozita, sepse ai ka thënë nga opozita. Si dhe në vend të fjalës minoritar, të përdoret fjala komunitete.

Kryesuesi, kërkoi nga shërbimi që në pajtim me ligjet dhe rregullat të përkthehen dokumentet në gjuhët respektive.

z. Riza Smaka, kërkoi të arsyetohet mungesa nga seanca paraprahe për shkak të mos informimit të tij, pa akuzuar askënd pasi që nuk kanë pasur numrin e telefonit adekuat dhe nuk kanë mundur te informojnë.

Kryesuesi, kërkoi që të merret parasysh kërkesa e Z. Smaka.

3. Diskutim mbi Propozim Mandatin e Komisionit;

Kryesuesi, bëri një rikapitulum mbi Tryezën e Rrumbullakët të organizuar me 08.10.2009 nga KIPRED nën patronatin e Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar ku janë diskutuar disa elemente të rëndësishme për funksionimin e këtij Komisioni dhe janë paraqitur përvoja nga shtete të ndryshme.

Materialet e paraqitura në atë tryezë janë sjellë për shqyrtim që të mundë të vihet deri te një propozim për mandat të Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike në mënyrë që ai propozim mandat pastaj ti dërgohet Komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës së Kuvendit.

Sa i përket vërejtjeve të z. Kervan për paragrafin 4 pikën (c), ky është vetëm një alternativë që të kemi një balancë në përfaqësimin e partive pozitive dhe opozitive në Komision. Gjithashtu edhe pika (d) është një sugjerim që të gjinden alternativa të përshtatshme për funksionimin e Komisionit. P.sh në këtë pikë mundë të themi se jo të gjithë anëtarët e KMFP të jenë njëkohësisht edhe anëtarë të KBF.

E gjitha është që të bëhet një ekuilibër i prezencës në Komision që vendimmarrja në Komision të jetë e ekuilibruar dhe vendimet të merren mundësisht sa më shumë me konsensus.

Gani Koci, ngriti dy çështje

- Çështja e përbërjes së Komisioneve bazohet në fuqinë politike në Kuvend. Ekziston vendimi i Kuvendit për themelimin dhe numrin e anëtarëve të këtij Komisioni, ne nuk mund të ndryshojmë vendimet e Kuvendit. Ne mund të bëjmë propozime për Kuvendin që të futen në rregulloren e re.
- Çështja e kompetencave të këtij komisioni dhe ndarja e kompetencave me Komisionin për Buxhet dhe Financa. Në disa pika si çështja e shqyrtimit të raporteve ekziston si kompetencë e të dyja Komisioneve, prandaj ne duhet të dimë se çfarë ti propozojmë Kuvendit, ti qartësojmë kompetencat e të dyja Komisioneve.

Kryesuesi, është e pamundur të behët ndarja e qartë e kompetencave të komisioneve prandaj disa ingerenca të jenë të pa ndara qartë. Krejt çka mundë të bëjmë është që pikat e fokusit të jenë të ndara.

Gani Koci, për vijat ndarëse në mes të komisioneve, sugjeroi që KMFP të shqyrtoj vetëm raportet e audituara të organizatave buxhetore. Ky do të ishte dallimi dhe vija ndarëse në mes të komisioneve. Ndërsa raportet e pa audituara të mbeten pjesë e KBF, jo që raportet e pa audituara të jenë të ndaluara nga shqyrtimi i këtij komisioni, por fokusi të jetë në raporte të audituara.

Arsim Rexhepi, përmendi që anëtarët duhet të fokusohen në efektin përfundimtar të komisionit.

Safete Hadergjonaj, raportet, përfshi këtu edhe raportet periodike, duhet të i dërgohen edhe KMFP-së mirëpo paritetin në diskutimin e këtyre raporteve dhe rekomandimet para Kuvendit ti takojnë KBF-së. Ndërsa nëse ka raporte periodike të audituara, atëherë ato duhet të jenë kompetencë ekskluzive e KMFP-së. Sa i përket Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike, këtë e bën KBF dhe nëse këtë e merr edhe KMFP atëherë kemi përzierje të kompetencave. Do të kishte qenë më mirë që ky Ligj ti lihet nën mbikëqyrje KBF-së.

Riza Smaka, Do të ishte mirë të kemi një kopje të mandatit të KBF-së që të shikohen kompetencat e këtyre dy komisioneve në suaza të kompetencave të njëri tjetrit. Ky është një Komision që është i autorizuar të shqyrtoj menaxhimin e financave publike karshi ligjit. Edhe pse ne jemi bukur shumë të varur nga raportet e auditorit, por nuk është mirë ta ngurtësojmë mandatin vetëm në raportet e audituara pasi që ne jemi Komisioni i Kuvendit dhe si i tillë kemi edhe metoda tjera të marrjes së informatave.

Ne po ashtu duhet të kemi edhe kompetenca hetuese dhe të jemi të autorizuar që të bëjmë mbikëqyrje të financave bazuar në kompetencat e shtuara që ky komision të mund të kërkojë çfarëdo materiali nga organizatat buxhetore.

Ky komision në të ardhmen duhet kryesisht të veprojë bazuar në të dhënat e KBF-së dhe të ZAP.

Synavere Rysha, përmendi se është vështirë të bëhet vija ndarëse në mes të KBF-së dhe KMFP-së për shkak të punëve të ndërlidhura. Por duhet të ekzistojë vija ndarëse. Përgjegjësitë e këtij Komisioni duhet të jenë përmbi vetëm shqyrtimit të raporteve të audituara, për shkak se me një çështje auditori mundë edhe të mos merret për vite të tëra.

Mënyra më e mirë e anashkalimit së dyfishimeve të punës së këtyre dy komisioneve është edhe marrja me disa raporte dhe ti bëhet publiciteti i mirëfilltë dhe kjo do të bëjë këtë komision kredibil, pasi që ne s'mund të diskutojmë dhe të mbikëqyrim të gjitha raportet. Por ky komision nuk do të duhej të jetë i limituar vetëm në raportet e audituara.

Gani Koci, tha se dallimi duhet të bëhet vetëm në raportet periodike dhe raportet e audituara pa hy në përgjegjësitë tjera. E përkrahë të drejtën që KMFP mos të jetë i ngurtësuar vetëm ne raporte të audituara. Këtij komisioni nuk i mohohet e drejta ta bëjë mbikëqyrjen e: Ligjit për Auditimin e Brendshëm, ligjit për raportimet financiare, etj.

Vija ndarëse duhet të ketë edhe në mbikëqyrjen e ligjeve, pasi që në disa aspekte KBF ka kompetenca ekskluzive në mbikëqyrjen e disa ligjeve, prandaj duhet të shikohet që në raportimin para Kuvendit të mos kemi raporte të dyfishta dhe kontradiktore.

Arsim Rexhepi, dhjet vite pas luftës dhe asnjë zyrtarë i këtij shteti nuk ka dhënë përgjegjësi për keq-menaxhimin e financave publike. Ne duhet rolin e mbikëqyrësit ta shndërrojmë në vepër. Ky komision duhet të ketë edhe ingerenca hulumtuese dhe hetuese për ta maksimizuar funksionin e këtij komisioni në procesin e mbikëqyrjes në një shtet që ka nivel të lartë të korrupsionit.

Kosara Nikolic, Ky komision nuk duhet të pres vetëm raportet e ZAP, pasi që në Kosovë bëhen shkelje të rënda, prandaj ne duhet të kemi edhe ingerenca jashtë raporteve të Auditorit.

Safete Hadergjonaj, nuk mundë të behet kontroll i mirëfilltë i financave publike pa raporte të auditorit pasi që ne nuk jemi kompetent të lexojmë disa nga aspektet e financave se si qëndrojnë dhe a janë apo jo të ligjshme.

Arsim Rexhepi, ngriti çështjen e PTK-së dhe humbjeve të kësaj organizate publike të cilës asnjëherë nuk iu është bërë asnjë auditim. Prandaj ky komision duhet të ketë në ingerenca të veta mbikëqyrjen edhe të ndërmarrjeve publike.

Synavere Rysha, tha se duhet të ketë dallim në mes të qasjes politike dhe qasjes profesionale në punë. Auditori është duke u apostrofuuar pa të drejtë pasi që në auditimin e këtyre ndërmarrjeve publike nuk ka pas vullnet politik në shqyrtimin dhe marrjen e masave ndaj këtyre ndërmarrjeve publike me theks të veçantë në RTK.

Kryesuesi, bëri thirrje të konkretizohet puna dhe të mos segmentizohet në suaza politike. Në parim ne do të merremi edhe me ligjshmërinë e shpenzimeve të këtyre ndërmarrjeve publike. Ne duhet të bëjmë programin e këtij komisioni, i cili duhet të jetë një dokument i gjallë. Ne gjithashtu duhet të iniciojmë amendamentimin e disa ligjeve në disa pika ku theksohet se ndaj kujt janë obligues organizatat buxhetore të raportojnë.

Kryesuesi shtroi edhe një pyetje se çfarë duhet të bëjë komisioni në raste kur ka shkelje drastike të financave publike?

Në leximin e Rregullores së Punës së Kuvendit në mandatin e KMFP-së gjegjësisht në piken e raporteve periodike, kryesuesi arsyetoi ekzistimin e kësaj pike në mandat pasi që në disa raste janë disa raporte që kanë bilance të pambyllura dhe nevojën e organizimit të dëgjimeve me organizata buxhetore të cilat kanë bërë shkelje edhe në raporte periodike. Kjo nuk do të çojë në dyfishim të punës, pasi që ekziston hapësirë e mjaftueshme për mbikëqyrje parlamentare të organizatave buxhetore në financa publike. Për shumë lëmi përveç komisioneve permanente raportojnë edhe komisionet funksionale, që është normale.

Në piken e raportimit para Kuvendit, kjo duhet të rishikohet se në çfarë periudhash dhe sa herë të raportoj ky komision para Kuvendit.

Gani Koci, përmendi se tani ky komision ka dy lloj propozimesh, i pari është drafti i rregullores së Kuvendit dhe i dyti draft mandati i propozuar. Në faqen 14, gjegjësisht në draft rregulloren e propozuar nga Kuvendi propozoi heqjen e pikës (1) që të mos jenë objekt shqyrtimi edhe raportet periodike.

Në draft propozimin e mandatit, propozoi amendamentimin e paragrafit (5) në krahasim me draft rregulloren e Kuvendit dhe të merret parasysh draft mandati i propozuar për KMFP. (gjej të bashkangjitur propozimet në mandatet e propozuara).

Gjithashtu propozoi që pika (c) e paragrafit 6 të hiqet në tersi nga mandati i KMPFP-së.

Te përbërja e komisionit, ne duhet të marrim praktikën e vendeve tjera. Nëse në shumicën e vendeve KMFP është nën-komision i KBF, pse duhet të jetë pengesë pjesëmarrja e një anëtari të KBF-ës në KMFP? Të gjitha këto që i cekta duhet të jenë pjesë e vendimmarrjes së Komisionit për mandate dhe rregullore.

Kryesuesi, tha se përveç dilemës së përbërjes së Kuvendit ekzistojnë edhe dilema tjera të shumta. Përbërjen e vendos Kuvendi, mirëpo ne mundë të japim sugjerimet tona dhe pastaj të presim aprovimin e Kuvendit.

Riza Smaka, propozoi që komisioni të quhet Komitet për mbikëqyrjen e financave publike. Sa i përket se çfarë të bëjë komisioni me shkelje të rënda, ai theksoi se është obligim i çdo qytetari të adresoj shkeljet para prokurorisë, prandaj edhe anëtarët e këtij komisioni janë të obliguar të adresojmë shkeljet tek prokuroria. Gjithashtu propozoi që të ketë komisioni autorizim të angazhojë ekspertë të lëmive të ndryshme me mjete vetanake që të ndihmohet komisioni në punën e tij.

Pikë kyçe e këtij komisioni të jetë mbikëqyrja e MEF dhe ZAP.

Kryesuesi, nëse pjesëmarrja vendoset të jetë problematike në të dy komisionet shprehu gatishmërinë që të heq dorë nga KBF dhe të shkoj në ndonjë komision tjetër.

Kryesuesi, po ashtu, bëri disa propozime lidhur me draftet e propozuara në mandatet e KMFP dhe KBF (shih propozimet në draft mandate). Ndërsa lidhur me ligjet që duhet të amendamentohen dhe ky Ligji për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm, Auditorët e Brendshëm, LMFP (pjesa e financave publike), Ligji i Prokurimit (një strukturë e caktuar). Mirëpo pyetja është se kush duhet të bëjë iniciimin e amendamentimit të ligjeve.

Gjithashtu u propozua që të shihen praktikën e vendeve tjera lidhur me aspektin se çfarë të bëjë Komisioni me shkeljet drastike që i evidenton në shpenzimet e financave publike nga organizatat buxhetore.

Krejt në përfundim propozoi që në mbledhjen e ardhshme të bëhet aprovimi i mandatit dhe me 15 dhjetor të ftohet Auditori Gjeneral në një dëgjim publik ku ZAP do të prezantoj funksionimin, problemet dhe vështirësitë që i ka has në auditimin e vitit të kaluar, etj.

Mbledhja përfundoi në 11:50

Përgatitur nga

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Haki SHATRI

